



REPUBLIKA E KOSOVËS /REPUBLICA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kryetarja e Komunës

01nr 400-9109

Dt: 18.02.2016

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 13 dhe 58 shkronja a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L-040, nenit 9 dhe 10 të Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve dhe Përfundimit nr.06-7288-3/1 të miratuar me dt: 09.02.2016 në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve, me të cilin është miratuar kërkesa e Shoqatës Sindikale e Pensionistëve të Komunës së Gjakovës për mbulimin e shpenzimeve për sigurimin e medikamenteve të cilat nuk gjenden në listën esenciale të barnave, me dt: 18.02.2016 e miraton këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Shoqatës Sindikale të Pensionistëve të Komunës së Gjakovës për mbulimin e shpenzimeve për sigurimin e medikamenteve të cilat nuk gjenden në listën esenciale të barnave, duke e mbështetur këtë kërkesë me subvencione të Zyrës së Kryetares së Komunës në vlerë prej 2,400.00€.

2. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të realizon procesin e zotimit të mjeteve financiare në vlerë prej 2,400.00€ nga mjetet e subvencioneve të Zyrës së Kryetares së Komunës dhe bartjen e këtyre mjeteve në xhirrollogarinë e Shoqatës Sindikale të Pensionistëve të Komunës së Gjakovës nr.1402000001782019 Banka Ekonomike.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

4. Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Drejtësisë për Shëndetësi dhe Mirëqeni Sociale
- Z. Esat Resyli, kryetar i Shoqatës Sindikale të Pensionistëve të Komunës së Gjakovës
- Arkivit

Kryetarja e Komunës,

Znj. Mimoza Kusari-Lila

